

- Kjo bankë është krijuar më 22.11.2006 dhe kapitali i saj themeltar është £100 (njëqind) stërlina;
- Drejtor i kësaj banke është caktuar z. Igor Kulenok më 07.7.2011 në moshën 27 vjecare, punësimi i tij i parë;
- Z. Kulenok edhe pse drejtor i një banke në Mbretërinë e Bashkuar ka adresë në 14 office 101. Promitheos Nicosia 1065 Qipro;
- Nënshkrimi noterial i lëshimit të garancisë bankare është kryer në Qipro;
- Referuar faqes së internetit të Bankës, merret informacion se shërbimet e saj nuk ofrohen në Mbretërinë e Bashkuar por vetëm jashtë saj.

Gjithashtu Avokatura e Shtetit sugjeron që AKBN t'i drejtohet dhe një herë z. Kulenok në adresën e sipër-përmendur dhe në rast të mos konfirmimit, t'i drejtohet kontraktorit për nxjerrjen e një garancie të re bankare duke ia specifikuar bankat nga të cilat mund të nxirret kjo garanci.

AKBN sipas sugjerimeve të Avokaturës së Shtetit, i dërgon shkresë z.Kulenok në adresën e sipër-përmendur (shkresa nr. 9996 Prot., datë 20.11.2014), i cili kthen përgjigje në emër të Bankës Garantuese Point Bank Ltd, me shkresën nr. 2760/1 Prot Hyrës dt. 03.03.2015, me anë të së cilës e refuzon pagesën e shumës së penaltetit prej 3.000.000 USD duke mos dhënë asnjë arsye për refuzimin. AKBN me shkresën nr. 2760/2 Prot datë 05.03.2015 kërkon arsyen e refuzimit dhe Point Bank kthen përgjigje me shkresën nr. 2760/3 duke ngritur pretendimin që ekzekutimi mund të bëhet nëpërmjet SWIFT mesazhi MT799 dhe më pas kjo kërkesë është subjekt i pranimit nga ana e tyre. AKBN në të tilla kushte i dërgon shkresë bankave të nivelit të dytë nëse kjo kërkesë e Point Bank është e realizueshme në bankat e tyre. Shkresat e mëposhtme:

1. Banka e Kreditit të Shqipërisë (nr. 2760/4 prot dt. 18.03.2015);
2. Veneto Bank (nr. 2760/5 prot dt. 18.03.2015);
3. Societe General Albania (nr. 2760/6 prot dt. 18.03.2015);
4. Union Bank (nr. 2760/7 prot dt. 18.03.2015);
5. Banka ndërkombëtare Tregtare (nr. 2760/8 prot dt. 18.03.2015);
6. Tiranë Bank (nr. 2760/9 prot dt. 18.03.2015);
7. Banka Kombëtare Tregtare (nr. 2760/10 prot dt. 18.03.2015);
8. Reiffeisen Bank (nr. 2760/11 prot dt. 18.03.2015);
9. Banka NBG Albania (nr. 2760/12 prot dt. 18.03.2015)
10. Pro Credit Bank (nr. 2760/13 prot dt. 18.03.2015);
11. Banka e Parë e Investimeve (nr. 2760/14 prot dt. 18.03.2015);
12. Intesa San Paolo (nr. 2760/15 prot dt. 18.03.2015);
13. Banka Credit Agricole (nr. 2760/16 prot dt. 18.03.2015);
14. Banka e Bashkuar e Shqipërisë (nr. 2760/17 prot dt. 18.03.2015);
15. Alpha Bank (nr. 2760/18 prot dt. 18.03.2015);
16. Credins Bank (nr. 2760/19 prot dt. 18.03.2015).



AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE

DREJTORI EKZEKUTIV

Sipas korrespondencës rezulton se vetëm 5 (pesë) banka që operojnë në tregun global kanë kthyer përgjigje, duke refuzuar mundesinë e dërgimit të kërkesës për pagesë, duke argumentuar se këto banka nuk kanë asnjë marrëveshje bashkëpunimi me bankën lëshuese për të dërguar mesazhe të autentifikuara SWIFT ku pjesë është dhe mesazhi SWIFT MT799.

Në të tilla rrethana, AKBN në përputhje me termat dhe kushtet e Licensë-Marrëveshjes dhe Marrëveshjes Hidrokarbure që ka me këtë operator, do ta ndjekë çështjen në gjyqësisht nëpërmjet institucioneve që përfaqësojnë shtetin shqiptar ndërkombëtarisht.